

Vend Vakant “Koordinator Projektsh” (diplomuar për Drejtësi)

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) shpall njoftimin për vend vakant, për pozicionin e punës me këto specifika:

- 1 (Një) Koordinator Projektsh
- Me kohë të plotë, 3 muajt e parë në provë konform Kodit të Punës

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore që do të ushtrohen në përmbushje të këtij pozicioni pune janë si vijon:

1. Ndjekja dhe mikqyrja e zbatimit të planit të aktiviteteve dhe planeve periodike të punës të projekteve që koordinon;
2. Të kontribuojë me cilësi dhe profesionalizëm në hartimin e shkresave drejtuar institucioneve, raporteve, studimeve, manualeve, broshurave, publikimeve, ndjekjen dhe përfaqësimin e çështjeve në gjykatë, etj..
3. Angazhohet në ekipet monitoruese të organizatës për çështjet e të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe shtetin e së drejtës si dhe përgatit së bashku me ekipin monitorues raportin përkatës.
4. Të supervizojë rregullisht dhe orientojë sipas nevojave, ekspertët, konsulentët, vëzhguesit, personat e kontaktit të institucioneve shtetërore të angazhuar në zbatimin e veprimtarive të projektit.
5. Të monitorojë dhe vlerësojë sistematikisht veprimtaritë me rëndësi të projektit.
6. Të rishikojë informacionet e përgatitura në kuadër të projektit, shqip/anglisht për faqen e internetit/social media të KShH-së dhe të propozojë përmirësimin e tyre.
7. Të raportojë për projektet që koordinon në kuadër të përgatitjes së raporteve periodike.
8. Të përgatisë dokumentat e nevojshëm për zbatimin e projektit (kontrata, terma reference, shkresa që iniciojnë një veprim financiar, raporte narrative progresive dhe finale, etj).
9. Të përfaqësojë organizatën sipas kërkesave të Drejtorit Ekzekutiv në media, aktivitete brenda dhe jashtë vendit.

Kandidati ose kandidatja për këtë pozicion duhet të plotësojë këto kriterë:

1. Të ketë përfunduar studimet e plotë (bachelor dhe master) për Drejtësi;
2. Të ketë mesatare të studimeve në Bachelor mbi 8.5 dhe në master mbi 8.5
3. Të paktën 3 vjet përvojë pune të dëshmuar si Asistent apo Koordinator Projekti ose rol të ngjashëm (nga konceptimi deri në zbatim dhe raportim) në organizata vendase, ndërkombëtare apo institucione publike.
4. Në mënyrë alternative, nëse kandidatët e interesuar nuk e përmbushin kriterin e parashikuar në pikën 3, ata duhet të kenë të paktën 3 vite përvojë si jurist pranë institucioneve publike, organizatave apo sektorit privat, nëse shfaqin aftësi shumë të mira multi-taksing dhe për të ndjekur brenda kohës së provës, me iniciativën e tyre, programe të veçanta trajnimi për të fituar njohuritë e duhura në fushën e koordinimit të projekteve.
5. Të ketë njohuri të avancuara teorike dhe praktike, përsa i takon të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
6. Të ketë aftësi shumë të mirë analitike të ligjit dhe zbatimit të tij si dhe aftësi shumë të mira në të shkruar dhe në të folur;
7. Të jetë njohës shumë i mirë i gjuhës angleze në të shkruar dhe në të folur (Sipas vërtetimeve të lëshuara nga Institucionet e licensuara që çertifikojnë njohuritë e gjuhës angleze)
8. Të jetë njohës dhe përdorues shumë i mirë i programeve bazë të kompjuterit
9. Të ketë aftësi shumë të mirë organizative, duke përfshirë multitasking dhe menaxhimin e kohës;
10. Të jetë i aftë të punojë në grup dhe të ketë aftësi shumë të mira ndërpersonale.
11. Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe prezantuese,

Mënyra e Aplikimit.

Të interesuarit të dërgojnë brenda datës 10 Shtator 2023, në adresën tonë elektronike office@ahc.org.al dokumentacionin e mëposhtëm:

1. CV;
2. Kopje të dokumentacionit shoqërues që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në pikat “1”, “2”, “3”, “4”, “7” dhe “8”, më sipër;
3. Një ose dy letra reference nga punëdhënësit e mëparshëm.

Mënyra e përzgjedhjes

Një komision seleksionimi brenda KShH-së do të vlerësojë të gjitha aplikimet e kandidatëve të interesuar.

Vetëm kandidatët që do të përzgjidhen në një listë të shkurtër do të njoftohen brenda datës 15 Shtator 2023, për një intervistë me komisionin e seleksionimit të kandidatëve në fazën e dytë të rekrutimit.

Paga për pozicionin është motivuese.